



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 728/2016

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv.Kryetar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.09.2016 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k, nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-43800-06-30-2016 me objekt: “*Loti 1-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalin Vjosë-Levan-Fier*”-*Rehabilitim i kanalit Sekondar-Dega e Pojanit*“ me fond limit 88,221,779 lekë pa tvsh, i parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.07.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: “Pesë Vëllezërit” shpk.
Libofshë, Fier

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Lagjia “Kastriot”, Rruga “Brigada XI Sulmuese”, Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili i ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.06.2016 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-43800-06-30-2016 me objekt: “*Loti I-Rehabilitim i rrjetit ujëtës me kanalën Vjosë-Levan-Fier*”-Rehabilitim i kanalit Sekondar-Dega e Pojanit“ me fond limit 88,221,779 lekë pa tvsh, i parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.07.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 26.07.2016 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 07.08.2016 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Shendelli”	nuk ka paraqitur ofertë
- “Pesë Vëllezërit”	76.309.102,00 I skualifikuar
- “Riviera”	79.391.365,00 I kualifikuar
- “Salillari”	88.188.942,00 I kualifikuar

II.4. Në datën 07.08.2016 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pesë Vëllezërit” sh.p.k & “G.P.G Company” sh.p.k është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

1. *Shoqëria “GPG Company”. shpk nuk plotëson kriterin lidhur me vërtetimin bankar. Kjo shoqëri ka paraqitur në tender dy vërtetime të tilla, ku vërtetimi i marrë nga “Raiffaissen Bank” mban datën 14.07.2016, është jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në kërkesat për kualifikim, kurse vërtetimi bankar i “NBG BANK” ska NIPT dhe IBAN. Në këto kushte, nuk plotëson shumën e gjendjes financiare sipas pikës 1.2., të kriterëve të vecanta të kualifikimit, lidhur me gjendjen monetare.*
2. *Shoqëria “5 Vëllezërit”. shpk në licensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punës së kontratës nuk i përfshin pikat N.P.12 (Punime te inxhinierise se mjedisit) dhe N.S.18. (Punime topogjeodezike). Ndërkohë kjo shoqëri sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë punime si: gjurmimi, mbushje, transporti, betoni, vendosje tuba fi 60 cm, rindërtimin e segmentit për mbikalimin, të cilat lidhen drejtpërdrejt me punimet topogjeodezike dhe punimet e inxhinierisë së mjedisit. Kjo shoqëri nuk është e licensuar që të kryejë punime të tilla, në kundërshtim me pikën 2.3 të kapacitetit teknik.*
3. *Shoqëria “GPG Company”. shpk ka paraqitur listpagesat e punonjësve të pakonfirmuara nga Dega e Tatim - Taksave, në kundërshtim me pikën 2.3/4., të kriterëve të vecanta të kualifikimit.*
4. *Shoqëria “5 Vëllezërit”.shpk nuk ka paraqitur leje qarkullimi, siguracion, aktkolaudim, për makinën Fadromë me goma, në kundërshtim me pikën 2.3/5 të disponimit për pajisjet / kapacitetet teknike.*
5. *Sipas kontratës së lidhur midis shoqërisë “5 Vëllezërit”.shpk dhe drejtuesit të vetëm teknik Ergys Metuli datë 4.6.2012 në nenin 8 përcaktohet se paga do të jetë 48 000 leke në muaj, ndërkohe në listpagesat e paraqitura, figuron në vlerën 40 000 leke në muaj. Kjo përbën fshehje të të ardhurave.*

II.5. Në datën 11.08.2016, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Pesë Vëllezërit” sh.p.k & “G.P.G Company” sh.p.k, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në ankesën drejtuar autoritet kontraktor, operatori ekonomik ankimues kundërshton vendimin e KVO-së datë 07.08.2016 në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

- I) *Përsa i përket skualifikimit të ofertës me arsyen se: Shoqëria “GPG Company” shpk nuk plotëson kriterin lidhur me vërtetimin bankar.Kjo shoqëri ka paraqitur në tender dy vërtetime të tilla,ku vërtetimi i marrë nga “Raiffaissen Bank” mban datën 14.07.2016 ,është jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në kërkesat për kualifikim,kurse vërtetimi bankar i “NBG Bank” ska NIPT dhe IBAN.Në këto kushte nuk plotëson shumën e gjendjes financiare sipas pikës 1.2.,të kriterëve të kualifikimit,lidhur me gjendjen monetare.*

Në dokumentet e tenderit është kërkuar : “Një vertetim të gjendjes financiare nga një bankë që verteton se shoqëria ka në llogari rrjedhese një shume jo me pak se 10 % e fondit limit për lotin që prokurohet, lëshuar jo me vonë se 10 dite përpara hapjes së ofertave si dhe të jene përfshirë nr. llogarise, Iban dhe NIPTI i shoqërisë. (Në rastin kur konkurohet për dy ose tre lote, llogaria rrjedhese duhet të jete sa 10% e fondit limit total për të dy ose tre lotet, lëshuar jo me vonë se 10 dite përpara hapjes së ofertave)”.

Në sistemin elektronik të prokurimit publik ,për këtë procedurë prokurimi kemi paraqitur :

-Vërtetim,lëshuar në datë 22.07.2016 ,nga “NBG Bank”,me vlerë 31.804.446 lekë.

Në pikën 3 ,të nenit 74,VKM nr 914,datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “,i ndryshuar”,përcaktohet se :” Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Vërtetimi i paraqitur për këtë procedurë është lëshuar nga një bankë e licensuar sipas ligjeve të fushës të Republikës së Shqipërisë.

Vlera financiare e gjëndjes së llogarisë së shoqërisë “G.P.G Company “ sh.p.k është shumë herë më e lartë se vlera e kërkuar në dokumentet e tenderit.

Formati i paraqitur për këtë procedurë prokurimi është formati standart i bankës dhe përmban të dhënat për të identifikuar titullarin e llogarisë bankare dhe numrin e llogarisë.Për sa i përket argumentimit tuaj se në të nuk janë pasqyruar të dhënat si IBAN-i dhe NIPT-i i shoqërisë dhe institucioni juaj para se të skualifikonte një ofertë të vlefshme ka patur në dispozicion të gjitha mjetet e mundshme për të verifikuar pranë bankës të dhënat e pasqyruara në vërtetim,datën e lëshimit,vlerën e pasqyrimet,titullarin e llogarisë bankare,etj.

Për më tepër :institucioni juaj ka patur në dispozicion edhe momentin e parashikuar në nenin 53 i ligjit i cili shprehet se : ‘Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji” dhe duhet të kishte informacionin bankës për përmbajtjen e dokumentit.Për këtë arsye skualifikimi i ofertës sonë me argumentimin e mësipërm nuk është i bazuar në ligj dhe në fakte.

II) Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit:

- 1. Shoqëria ‘5 Vëllezërit “ sh.p.k në licensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punës së kontratës nuk i përfshin pikat N.P.12 (Punime të inxhinierisë së mjedisti) dhe N.S.18 (Punime topogjeodezike). Ndërkohë kjo shoqëri sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë punime si: gërmimi,mbushje,transporti,betoni,vendosja tuba fi 60 cm, rindërtimin e segmentit për mbikalimin, të cilat lidhen drejtpërdrejt me punimet topogjeodezike dhe punimet e inxhinierisë së mjedisit. Kjo shoqëri nuk është e licensuar të kryejë punime të tilla,në kundërshtim me pikën 2.3 të kapacitetit teknik.*

Në dokumentat e tenderit është kërkuar: Licënsa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës :Punime gjërmimi në tokë N.P.1,-Klasifikim “A “: Ndërtime civile industriale N.P.2,-Klasifikim “A” (kur konkurohet për të dy lotet:Klasifikimi “B”):Ujësjellësa,gazsjellësa,vepra kullimi e vaditje N.P.7,-Klasifikim “C”.9kur konkurohet për të dy lotet:Klasifikimi “D”);Punime të inxhinierisë së mjedisit N.P.12,-Klasifikim “A” .(kur konkurohet për të dy lotet :Klasifikimi “B”) ;Punime topogjeodezike N.S.18,-Klasifikim “B”.(kur konkurohet për të dy lotet : Klasifikimi “C”).

Në sistemin elektronik të prokurimit publik,për këtë procedurë prokurimi kemi paraqitur:

-Licensë ;Nr 6804 datë 05.05.2016, e subjektit ‘Pesë Vëllezërit ‘ shpk.Shoqëria ‘Pesë Vëllezërit ‘ shpk është pajisur me kategoritë e punimeve :NP 1 B,NP 2 A,NP 3 A,NP 4 A,NP 7 C,NS 1 A,NS 2 A,NS 4 A,NS 6 A dhe NS 7 A.

Në këtë procedurë prokurimi,kemi paraqitur ofertë si bashkim i përkohshën i operatorëve ekonomik.

Në marrëveshjen noteriale nr.1289 Rep,nr.570 Kol,datë 22.07.2016 palët kanë rënë dakort :”Shoqëria “G.P.G Company” shpk do të realizoj 78.7 % të punimeve dhe pikërisht këta zëra punimesh :”Zëri i punimeve nr.2,”Prerje pemësh fi 10-20 cm”,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr.3,”Gjërmim dheu për riseksionimin e kanalit 80 5 me makineri “,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr 7,”Beton M-100 për shtresën nën veshje “sasia 2250 m³,Zëri i punimeve nr 8,”Beton M-200 për veshje “,të gjithë sasinë. Zëri i punimeve nr 9 “F.vendosje hekur Fi 10 mm për përforcimin e veshjes”,sasia 55 ton. Zëri i punimeve nr 10,”beton M-200 për riparime mure e vepra arti ekzistuese”,të gjithë sasinë. Zëri i punimeve nr 12 “Riparim garazhi me 2 porta metalike (analizë)”,të gjithë sasinë. Zëri i punimeve nr.13 “Riparimi i kalimeve me lugje b/arme zonat e dëmtuara (analizë për 1 ml)”,të gjithë sasinë. Zëri i punimeve nr 14 ‘Rindërtimi i një segmenti (me ulje të madhe) i lugut për mbikalimin e KUL (Kanal i ujërave të larta) Levan – Pojan (analizë për 1 ml)”,sasia 15 ml. Zëri i punimeve nr 15 “Furnizim e vendosje porta metalike të reja në vepra ekz.copë 5 “,të gjithë sasinë’.

Në marrëveshjen noteriale palët kanë rënë dakort :Shoqëria “Pesë Vëllezërit” shpk do të realizoj 21.3 % të punimeve dhe pikërisht këto zëra punimesh :”Zëri i punimeve nr 1 “Gjërmim për skarifikim,prerje e shkulje bime të vogla deri në 10 cm ‘,të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 4 “Gjërmim dheu për riseksionim kanali me ngarkim në mjet’të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 5 “Mbushje e ngjeshje me dhë për riseksionim kanali” të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 6 “Transport dheu me auto distance 2 km (10 % e sasisë së gjërmimit)” të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 7 “Beton M-100 për shtresën nën veshje”,sasia 511 m³.Zëri i punimeve nr 11 ”Prize me tub fi = 60 cm , L= 4 m (me porta me aks te gjate) Analize “ të gjithë sasinë,Zëri i punimeve nr 14 ,” Rindërtimi I një segmenti (me ulje te madhe) i lugut për mbikalimin e KUL (Kanal I ujërave te larta) Levan- Pojan (analize për 1 ml)” sasia 15 ml “.

Në pikën 3,të nenit 74,VKM nr 914 ,datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “ i ndryshuar,përcaktohet se :” Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.Përsa i përket skualifikimit me arsyen se shoqëria “5 Vëllezërit “shpk në licensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punës së kontratës nuk i përfshin pikat N.P.12 (Punime të inxhinierisë së mjedisit) dhe N.S.18 (Punime gjeodezike) duhet të theksohet

se :E drejta e licensimit për të ushtruar aktivitet ndërtimor rregullohet nga VKM nr.42,datë 16.01.2008.

Në kreun III.” Kategorizimi dhe klasifikimi i licensës ,elementët e saj,kushtet,kriteret dhe kufizimet “,pika 1 ,gërma “a” ,I,të VKM nr.42,datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi “,parashikohet se : ‘Licensa është dokument juridik e profesional,që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar ,sipas :I.Kategorive të punimeve të zbatimit”.

Në kreun III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licensës, elementet e saj, kushtet,kriteret dhe kufizimet” të të VKM nr.42,datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi “ parashikohet se “Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4”.

Ndërkohë në kreun V “Mënyra e Klasifikimit të Shoqërive ‘ parashikohet se :” 1. Klasifikimi i shoqërive a) Shoqëria vendoset paraprakisht në nivelin (klasën) e pasqyruar në lidhjen nr.4, ku përfshihet vlera e punimeve të kryera gjatë 4 viteve të fundit për kategorinë që klasifikohet. Shoqëria qëndron në të njëjtin nivel klasifikimi apo zbret në një më të ulët në varësi të pikëve që përfiton nga përvoja e drejtuesit teknik të shoqërisë për kategorinë që klasifikohet dhe pikët nga kapaciteti financiar nëpërmjet bilanceve, të llogaritura si në vijim”.

Në lidhjen Nr.2,të VKM nr.42,datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi “,”Tabela”,”Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit në ndërtim ‘,në të cilën parashikohen kategoritë dhe klasifikimi i punimeve për të cilat subjektet ndërtuese licensohen.

Në lidhjen nr.3, të VKM nr.42,datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi “, Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme “,jepet shpjegim mbi fushën e veprimtarisë ndërtimore për secilën kategori punimesh.

Në këtë lidhje përcaktohet se kategoria e punimeve NP 12,i referohet : “Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik,konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve

dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte”.

Në këtë lidhje përcaktohet se kategoria e punimeve NS 18,i referohet :” N.S - 18 Punime topogjeodezike.Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh”.

Ndërsa :

Në këtë lidhje përcaktohet se kategoria e punimeve NP 1 ,i referohet ;” N.P. 1 Punime gjermimi në tokë.Konsiderohen gjermimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjermohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore”.

Në këtë lidhje përcaktohet se kategoria e punimeve NP 2,i referohet :” N.P. 2 Ndërtime civile e industriale.Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderrur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse”.

Në këtë lidhje përcaktohet se kategoria e punimeve NP 7 ,i referohet :” N.P. 7: Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjiellësat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura”.

Në marrëveshjen noteriale nr 1289 Rep,nr.570 Kol,datë 22.07.2016,Shoqëria “Pesë Vëllezërit “ sh.p.k ka marrë përsipër :

- Zëri i punimeve nr 1 “Gjermim për skarifikim,prerje e shkulje bime të vogla deri në 10 cm ‘të gjithë sasinë,.Këto punime kanë të bëjnë me punime gjermim dheu,kategori e cila,sipas VKM_së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 1.

-Zëri i punimeve nr 4 “Gjermim dheu per riseksionim kanali me ngarkim ne mjet’të gjithë sasinë. Këto punime kanë të bëjnë me punime gjermim dheu,kategori e cila,sipas VKM_së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 1.

-Zëri i punimeve nr 5 “Mbushje e ngjeshje me dhë per riseksionim kanali” të gjithë sasinë. Këto punime kanë të bëjnë me punime germim dheu,kategori e cila,sipas VKM_së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 1.

-Zëri i punimeve nr 6 “Transport dheu me auto distance 2 km (10 % e sasise se germimit)” të gjithë sasinë. Këto punime kanë të bëjnë me punime germim dheu,kategori e cila,sipas VKM_së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 1.

-Zëri i punimeve nr 7 “Beton M-100 per shtresen nen veshje”,sasia 511 m³. Këto punime kanë të bëjnë me punime ndërtimore, kategori e cila,sipas VKM-së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 7.

-Zëri i punimeve nr 9 F.Vendosje hekur Fi 10 mm per perfocimin e veshjes”,sasia 54,506 ton. Këto punime kanë të bëjnë me punime ndërtimore, kategori e cila,sipas VKM_së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 7.

-Zëri i punimeve nr 11 ” Prize me tub fi = 60 cm , L= 4 m (me porta me aks te gjate)Analize “ të gjithë sasinë. Këto punime kanë të bëjnë me punime ndërtimore, kategori e cila,sipas VKM_së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 7.

-Zëri i punimeve nr 14 ,” Rindertimi I nje segmenti (me ulje te madhe) i lugut per mbikalimin e KUL (Kanal I ujravave te larta) Levan- Pojan (analize per 1 ml)” sasia 15 ml. Këto punime kanë të bëjnë me punime ndërtimore, kategori e cila,sipas VKM-së nr 42,datë 16.01.2008,sipas kategorisë së punimeve NP 7.

Në nenin 46 pika 1,gërma “b” të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik “ i ndryshuar parashikohet shprehimisht :” Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.

Në pikën 3 ,të nenit 53,të LPP-së përcaktohet se :” Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme,vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Kriteret për kaulifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë,të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike,profesionale,kapacitetet organizative,makineritë,pajisjet e asete të tjera fizike,reputacionin dhe besueshmërinë,përvijën e duhur,si dhe personelin e nevojshëm,gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Për sa më sipër kemi argumentuar se shoqëria “Pesë Vëllezërit ‘ sh.p.k ka marrë përsipër realizimin e punimeve që nuk kanë të bëjnë me kategoritë e licebsave që pretendoni ju në arsyetimin e skualifikimit.Për këtë arsye skualifikimi i ofertës sonë me argumentin e mësipërm nuk është i bazuar në ligj dhe në fakte.

III) Përsa i përket skualifikimit të ofertës me arsyen se: Shoqëria “GPG Company” shpk ka paraqitur listëpagesat e punonjësve të pakonfirmuara nga Dega e Tatim-Taksave,në kundërshtim me pikën 2.3/4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar : “Listepagesat per periudhen e mesiperme Esig 025 ,te konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave ku eshte i regjistruar OP”.

Në sistemin elektronik të prokurimit publik,për këtë procedurë prokurimi kemi paraqitur :

Të gjitha listëpagesat për periudhën janar 2015 deri dhjetor 2015 si edhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Tatimore mbi numrin e punonjësve të deklaruar për të cilët janë paguar detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi.

Në nenin 65,pika 6, e Ligjit nr 9920,datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore” ,i ndryshuar,i cili parashikon se : “ Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore,vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

Në nenin 1,të VKM nr.55,datë 03.02.2010 ,”Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjerë tatimore vetëm nëpërmjet formës elektronike”,të ndryshuar,parashikohet se :” Deklarimin e detyrueshëm,vetëm nëpërmjet formës elektronike,të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore,objekt i këtij vendimi,me të cilat nënkuptohen ;vi)listëpagesës së kontributeve e sigurimeve shoqërore,shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi “.

Në njoftimin e datës 14.01.2013 ,të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,ndër të tjera përcaktohet se “Duke filluar nga periudha tatimore Janar 2013,deklarimi i listëpagesave E-Sig 025 dhe Formularëve të ndryshimit të numrit të punonjësve E-Sig 027 do të kryhen në mënyrë elektronike “.

Për sa më sipër,dorëzimi i listëpagesave elektronike nga shoqëria “G.P.G Company “,përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor.Kjo është trajtuar edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin 118/2016.Për këtë arsye skualifikimi i ofertës sonë me argumentin e mësipërm nuk është i bazuar në ligj dhe në fakte.

IV) Përsa i përket skualifikimit të ofertës me arsyen se: Shoqëria ‘5 Vëllezërit ‘ sh.p.k nuk ka paraqitur leje qarkullimi,siguracion,aktkolaudim,për makinën Fadromë me goma,në kundërshtim me pikën 2.3/5 të disponimit për pajisjet / kapacitetet teknike.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar : “Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës per lotin qe konkuron:...Fadroma me goma,copë 1 (një)...”

Në këtë procedurë prokurimi,kemi paraqitur ofertë si bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomik.

Në marrëveshjen noteriale nr.1289 Rep,nr.570 Kol,datë 22.07.2016 palët kanë rënë dakort :”Shoqëria “G.P.G Company” shpk do të realizoj 78.7 % të punimeve dhe pikërisht këta zëra punimesh :”Zëri i punimeve nr.2,”Prerje pemësh fi 10-20 cm”,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr.3,”Gërmim dheu për riseksionimin e kanalit 80 5 me makineri “,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr 7,”Beton M-100 për shtresën nën veshje “sasia 2250 m³,Zëri i punimeve nr 8,”Beton M-200 për veshje “,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr 9 “F.vendosje hekur Fi 10 mm për përforcimin e veshjes”,sasia 55 ton.Zëri i punimeve nr 10,”beton M-200 për riparime mure e vepra arti ekzistuese”,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr 12 “Riparim garazhi me 2 porta metalike (analizë)”,të gjithë sasinë.Zëri i punimeve nr.13 “Riparimi i kalimeve me lugje b/arme zonat e dëmtuara (analzië për 1 ml)”,të gjithë sasinë. Zëri i punimeve nr 14 ‘Rindërtimi i një

segmenti (me ulje të madhe) i lugut për mbikalimin e KUL (Kanal i ujërave të larta) Levan – Pojan (analizë për 1 ml)”,sasia 15 ml. Zëri i punimeve nr 15 “Furnizim e vendosje porta metalike të reja në vepra ekz.copë 5 “,të gjithë sasinë’.

Në marrëveshjen noteriale palët kanë rënë dakort :Shoqëria “Pesë Vëllezërit” shpk do të ralizoj 21.3 % të punimeve dhe pikërisht këro zëra punimesh :

“Zëri i punimeve nr 1 “Gërmim për skarifikim,prerje e shkulje bime të vogla deri në 10 cm ‘,të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 4 “Gërmim dheu për riseksionim kanali me ngarkim në mjet’të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 5 “Mbushje e ngjeshje me dhë për riseksionim kanali” të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 6 “Transport dheu me auto distance 2 km (10 % e sasise së gërmimit)” të gjithë sasinë, Zëri i punimeve nr 7 “Beton M-100 për shtresën nën veshje”,sasia 511 m³.Zëri i punimeve nr 11 ” Prize me tub $f_i = 60 \text{ cm}$, $L = 4 \text{ m}$ (me porta me aks të gjatë)Analize “ të gjithë sasinë,Zëri i punimeve nr 14 ,” Rindertimi I një segmenti (me ulje të madhe) i lugut për mbikalimin e KUL (Kanal I ujërave të larta) Levan- Pojan (analize për 1 ml)” sasia 15 ml “.

Në sistemin elektronik të prokurimit publik të Agjensisë së Prokurimit Publik,për këtë procedurë prokurimi shoqëria “Pesë Vëllezërit ‘ sh.p.k ka paraqitur :

-Kontratë qiramarrje,Nr.363 Rep,Nr. 137 Kol.,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Fadrome (TL12076).

- Kontratë qiramarrje,Nr.363 Rep,Nr. 137 Kol.,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Eskavator (ZEF113TEN5LA03550).

- Kontratë qiramarrje,Nr.363 Rep,Nr. 137 Kol.,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Eskavator me zinxhir(2-N5LA03179) dhe rrul (61910507).

-Kontratë qiramarrje,Nr.351 Rep,Nr.143 Kol,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Eskavator (3LL01167) (me zinxhir) krah gjatë 15 m.

- Kontratë qiramarrje,Nr.351 Rep,Nr.143 Kol,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Eskavator (CATERPILAR 323D)(Me zinxhir) krah gjatë 15 m.

- Kontratë qiramarrje,Nr.351 Rep,Nr.143 Kol,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Eskavator Me Goma (fadromë) (8FN00887).

-Kontratë qiramarrje , Nr.351 Rep,Nr.143 Kol,datë 29.02.2016 ,për marrje me qira të mjetit: Traktor (Me zinxhir) (8J1530).

Në sistemin elektronik të prokurimit publik të Agjensisë së Prokurimit Publik,për këtë procedurë prokurimi shoqëria ‘G.P.G Company “ shpk ka paraqitur :

-Fadromë me goma Kamatsu (EA30H21113).

-Fadromë Libherr me goma (4437825).

-Fadroma Fiat Hitachi (582629).

-Eskavator me goma OK MH City (74577).

-Eskavator me goma Fiat Kobeleco (ZEF157ETA00000674).

-Eskavator CAT 330 (8CK00425).

Në nenin 46,pika 1 ,gërma “b” të ligjit nr.9643 ,datë 20.11.2006 “Për rprokurimin Publik “,i ndryshuar,parashikohet shprehimisht :” Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni,

vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Në pikën 3, të nenit 74, VKM nr 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “, i ndryshuar, përcaktohet se : “ 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Përsa i përket skualifikimit me arsyen se Shoqëria “Pesë Vëllezërit “shpk nuk ka paraqitur lejë qarkullimi, siguracion, aktkolaudim, për makinën Fadromë me goma duhet të theksohet se : Në dokumentet e tenderit është kërkuar : fadromë me goma, copë 1 (një).

Së pari sa parashtruar më sipër argumentuar se shoqëria “Pesë Vëllezërit “ shpk ka marrë përsipër realizimin e punimeve, për realizimin e të cilave ka paraqitur edhe të gjitha makineritë e duhura për realizimin e punimeve, për realizimin e të cilave ka paraqitur edhe të gjitha makineritë e duhura për realizimin me sukses të punimeve. Ka paraqitur dokumentacion për mjetet fadromë me goma, eskavator, traktor me zinxhirë, etj.

Së dyti , në marrëveshjen noteriale nr.1289 Rep., nr.570 Kol., datë 22.07.2016 , palët kanë rënë dakort : “Shoqëria “G.P.G Company “ shpk do të realizoj 78.7 % të punimeve. Pra shoqëria “G.P.G Company “ shpk është shoqëri lider në përqindjen e kryerjes së punimeve dhe duhet të plotësoj pjesën më të madhe të kriterëve dhe kushteve. Në rastin tonë, në kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit, është kërkuar vetëm një fadromë dhe kjo kërkesë është plotësuar nga ky anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik. Nëse ky kriter është plotësuar nga shoqëria “G.P.G Company “ shpk , e cila ka marrë përsipër realizimin e punimeve me mjetin fadromë, përse duhet të paraqesë edhe shoqëria “Pesë Vëllezërit “ shpk dokumentacionin për një fadromë të dytë ?

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për këtë arsye skualifikimi i ofertës sonë me argumentin e mësipërm nuk është i bazuar në ligj dhe në fakte.

V) Përsa i përket skualifikimit të ofertës me arsyen se: Sipas kontratës së lidhur midis shoqërisë “5 Vëllezërit’ shpk dhe drejtuesit të vetëm teknik Ergys Metuli datë 04.06.2012 në nenin 8 përcaktohet se paga do të jetë 48 000 lekë në muaj, ndërkohë në listëpagesat e paraqitura, figuron në vlerën 40 000 lekë në muaj.

Në dokumentat e tenderit është kërkuar : “2.3/3 Shoqëria duhet të ketë në stafin e tij drejtues, për lotin që konkuron: Inxhinier ndertimi (profili rruga –ura ose transport -infrastruktura) 1(nje), Inxhinier mjedisi, 1(nje) Inxhinier topograf 1(nje), Inxhinier hidroteknik 1(nje), Shoqeruar me Cv, diplome, libreze pune dhe të figurojnë në liste pagesat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit.” Në sistemin elektronik të prokurimit publik , për këtë procedurë prokurimi kemi paraqitur :

-Kontratë pune Nr.249 rep.,Nr 1279 Kol.,datë 04.06.2012,Diplomë Nr.2651,datë 20.07.2005,Cv personale e z.Ergys Metuli ,Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik nr.00119,Librezë Pune.

-Listëpagesat e shoqërisë “Pesë Vëllezërit ‘ shpk dhe vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore.

Në pikën 3,të nenit 53,të LPP-së,përcaktohet se :” Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme,vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rëndësi ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

Pra Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësoj një ofertë të paraqitur vetëm në bazë të kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe dokumentacionit përkatës të paraqitur nga ofertuesi.

Së pari në dokumentet e tenderit është kërkuar : “...dhe te figurojne ne liste pagesat e shoqërisë per 6 (gjashte) muajt e fundit.”.Pra ne kemi kemi paraqitur dokumentacionin e kërkuar për Ing.Ergys Metuli i cili figuron në listëpagesat e shoqërisë “Pesë Vëllezërit “ shpk.

Së dyti lidhur me argumentin se në nenin 8 përcaktohet se paga do të jetë 48.000 lekë në muaj,ndërkohë që në listëpagesat paraqitura,figuron në vlerën 40.000 lekë në muaj ,gjykojmë se,është në kompetencën e organeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore ndjekja e zbatimit të legjislacionit në fuqi lidhur me pagesën e punonjësve.Autoriteti Kontraktor nuk ka kompetencë ligjore të ndjekë zbatimin e legjislacionit lidhur me pagesën e punonjësve dhe për më tepër në asnjë rast nuk e ka përmendur si kriter kualifikues në dokumentet e tenderit.

Në nenin 46,pika 1,gërma “b” të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik “, i ndryshuar ,parashikohet se :” Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.Ne kemi vërtetuar me dokumentacion se plotësojmë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga Autoriteti Kontraktor.Për këtë arsye skualifikimi i ofertës sonë me argumentin e mësipërm nuk është i bazuar në ligj dhe në fakte.

II.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.5356/4 prot datë 17.08.2016 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Pesë Vëllezërit” sh.p.k në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij, duke vendosur pjesërisht pranimin e ankesës. Më konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka pranuar ankesën lidhur me paraqitjen e listëpagesave të punonjësve të pakonfirmuara nga Dega e Tatim-Taksave.

II.7. Në datën 26.08.2016, operatori ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Njëpërmjet shkresës nr. 5721/1 prot., datë 31.08.2016, protokolluar me tonën 1907/2, datë 05.09.2016 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pesë Vëllezërit” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “Shoqëria “GPG Company”. shpk nuk plotëson kriterin lidhur me vërtetimin bankar. Kjo shoqëri ka paraqitur në tender dy vërtetime të tilla, ku vërtetimi i marrë nga “Raiffaissen Bank” mban datën 14.07.2016, është jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në kërkesat për kualifikim, kurse vërtetimi bankar i “NBG BANK” ska NIPT dhe IBAN. Në këto kushte, nuk plotëson shumën e gjendjes financiare sipas pikës 1.2., të kriterëve të vecanta të kualifikimit, lidhur me gjendjen monetare”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumentave të procedurës objekt ankimimi, në pikën 1.2 përcaktohet se:

- *Një vërtetim të gjendjes financiare nga një banke që vërteton se shoqëria ka në llogari rrjedhese një shumë jo më pak se jo më pak se 10 % e fondit limit për lotin që prokurohet, leshuar jo më vonë se 10 dite përpara hapjes së ofertave si dhe te jene perfshire nr. llogarise, Iban dhe NIPTI i shoqërisë. (Ne rastin kur konkurohet për dy lote, llogaria rrjedhese duhet të jete sa 10% e fondit limit total për të dy lotet, leshuar jo më vonë se 10 dite përpara hapjes së ofertave)*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm operatorit ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k. ka dorëzuar:

- *Vërtetim bankar date 14.07.2016, leshuar nga Raiffeisen Bank, me ane të te cilit vërtetohet se shoqëria " G.P.G Company " sh.p.k., me llogari rrjedhëse, në ALL me nr. X, Kodi Iban Y, banaca e disponueshme në llogari në datë 14.07.2016 është 27,075,416.29 ALL;*
- *Vërtetim bankar date 22.07.2012, leshuar nga NBG Bank, me ane të te cilit vërtetohet se shoqëria " G.P.G Company " sh.p.k., ka balancë të llogarisë shumen prej 31,804,446 lekë;*

III.1.3 Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret (ekonomike) për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës dhe në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Referuar dokumentave standarte të kësaj procedure prokurimi, AK ka përcaktuar detyrimin për t’u paraqitur “Vërtetim të gjendjes financiare”, dhe në gjykimin e tij, AK ka kërkuar si kusht për vlefshmërinë e këtij dokumenti, atë të respektimit të ***kufizimit me afatin 10 ditor*** nga data e hapjes së ofertave, brenda të cilit duhet të jetë lëshuar për të plotësuar kriterin e vendosur në DST, si dhe ***shuma e deklaruar të jetë jo më e ulët se 10 % të vlerës së fondit limit.***

- Lidhur me respektimin e afatit 10 ditor, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur prej operatorit ekonomik “G.P.G Company” shpk, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi (cituar në pikën III.1.2. të arsyetimit), rezulton se dokumenti “Vërtetim” lëshuar nga Raiffeisen Bank daton më datë 14.07.2016, ndërkohë data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi ka qenë më datë 26.07.2016, për rrjedhojë ky vërtetim është përtej afatit 10 ditor.

III.1.5. Ndërsa për vërtetimin tjetër bankar të “NBG Bank”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se me paraqitjen e këtij vërtetimi bankar datë 22.07.2012, lëshuar nga NBG Bank, vërtetohet se shoqëria “G.P.G Company” sh.p.k., ka balancë të llogarisë shumë prej 31,804,446 leke, operator ekonomik ka dëshmuar se është në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor. Pretendimi i autoritetit kontraktor se vërtetimi bankar nuk është paraqitur sipas kriterit të përcaktuar nga kriteret e veçanta të kualifikimit, nuk mund të merret i mirëqënë përse kohë vërtetimi përmban të dhëna për të identifikuar titullarin e llogarisë bankare dhe numrin e llogarisë. Format i paraqitur në këtë rast kushtëzohet nga formati standart që përdorin bankat në lëshimin e këtyre dokumentacioneve, përse kohë operator ekonomik ankimues përmbush vlerën 10 % të fondit limit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, vërtetimi bankar do të konsiderohet se plotëson kriterin e vendosur nga AK.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Pesë Vëllezërit” sh.p.k për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *“Shoqëria ‘5 Vëllezërit’ sh.p.k në licensën profesionale lidhur me ekzekutimin e punës së kontratës nuk i përfshin pikat N.P.12*

(Punime të inxhinierisë së mjedisit) dhe N.S.18 (Punime topogjeodezike). Ndërkohë kjo shoqëri sipas kontratës së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë punime si: gërmimi, mbushje, transporti, betoni, vendosja tuba fi 60 cm, rindërtimin e segmentit p ër mbikalimin, të cilat lidhen drejtpërdrejt me punimet topogjeodezike dhe punimet e inxhinierisë së mjedisit. Kjo shoqëri nuk është e licensuar të kryejë punime të tilla, në kundërshtim me pikën 2.3 të kapacitetit teknik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës objekt ankimimi, në pikën 2.3/2 përcaktohet se:

2.3/2 *Liçensa profesionale te shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës :*

- *Punime gërmimi ne toke N.P.1, -Klasifikim ‘A ’*
- *Ndertime civile industriale N.P.2,- Klasifikim ‘A’(kur konkurohet per te dy lotet: Klasifikimi “B”)*
- *Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje N.P.7, -Klasifikim ‘C’. (kur konkurohet per te dy lotet: Klasifikimi “D”)*
- *Punime te inxhinierise se mjedisit N.P.12, -Klasifikim ‘A’. (kur konkurohet per te dy lotet: Klasifikimi “B”)*
- *Punime topogjeodezike N.S.18, -Klasifikim ‘B’.((kur konkurohet per te dy lotet: Klasifikimi “C”)*

III.2.2. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se :

“1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.....

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.2.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Pesë Vëllezërit” sh.p.k & “G.P.G Company” sh.p.k. ka dorëzuar:

- Deklaratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive lidhur para një noteri publik Nr.1289 Rep dhe Nr.570 Kol, datë 22.07.2016. Nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit rezulton se referuar “Objektit” të kontratës, bashkimi i përkohshëm i shoqërive është krijuar mbi zbatimin e objektit “Loti I-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal in Vjosë Levan Fier”- Rehabilitim i kanalit Sekondar-Dega e Pojanit” (objekt i procedurës së prokurimit objekt ankimi). Në kontratë është parashikuar: “Palët subjekte në këtë deklaratë bashkëpunimi prezente marrin përsipër që të përgjigjen solidarisht ndaj cdo detyrimi që buron nga kontrata, dhe në atë të realizimit të objekteve në përputhje me nenin 423 të K.C”. Pjesëmarrja e palëve në grup do të përcaktohet sipas këtyre raporteve:

- Shoqëria “G.P.G Company” sh.p.k do të realizojë 78.7 % të punimeve, sipas preventivit të ofertës dhe përkatësiht keto zëra punimesh:

Preventivi i punimeve

- Zëri i punimeve nr. 2 “Prerje pemesh Φ 10-20 cm”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 3 “Germim dheu per riseksionimin e kanalit 80 % me makineri”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 7 “Beton M-100 per shtresen nen veshje”, sasia 2.250 m³
- Zëri i punimeve nr. 8 “Beton M-200 per veshje”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 9 “ F.Vendosje hekur Φ 10 mm per perfocimin e veshjes” , të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 10 “Beton M-200 per riparime mure e vepra arti egzistuese “,të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 12 “Riparim barazhi me 2 porta metalike (analize)”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 13 “Riparimi i Kalimeve me lugje b/arme zonat e demtuara (anlize per 1 ml)”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 14 “Rindertimi i nje segmenti (me ulje te madhe) i lugut per mbikalimin e KUL (Kanal i ujrave te larta) Levan- Pojan (analize per 1 ml)”, sasia 15 ML
- Zëri i punimeve nr. 15 “Furnizim e vendosje porta metalike te reja ne vepra ekz. cope 5”, të gjithë sasinë.

- Shoqëria “Pesë Vëllezërit” sh.p.k do të realizojë 21.3 % të punimeve, sipas preventivit të ofertës dhe përkatësiht keto zëra punimesh:

Preventivi i punimeve

- Zëri i punimeve nr. 1 “ Germim per skarifikim, prerje e shkulje bime te vogla Φ deri 10 cm”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 4 “ Germim dheu per riseksionim kanali me ngarkim ne mjet”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 5 “ Mbushje e ngjeshje me dhë per riseksionim kanali”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 6 “ Transport dheu me auto distance 2 km (10 % e sasise se germimit)”, të gjithë sasinë
- Zëri i punimeve nr. 7 “ Beton M-100 per shtresen nen veshje” , sasia 511 m³

- Zëri i punimeve nr. 9 “ F.Vendosje hekur Φ 10 mm per perfocimin e veshjes”, sasia 54,506 Ton
 - Zëri i punimeve nr. 11 “ Prize me tub $\Phi = 60$ cm, $L = 4$ m (me porta me aks te gjate) Analize” , të gjithë sasinë
 - Zëri i punimeve nr. 14 “ Rindertimi i nje segmenti (me ulje te madhe) i lugut per mbikalimin e KUL (Kanal i ujrave te larta) Levan- Pojan (analize per 1 ml)”, sasia 15 ML.
 - Zëri i punimeve nr. 14 “Rindertimi i nje segmenti (me ulje te madhe) i lugut per mbikalimin e KUL (Kanal i ujrave te larta) Levan- Pojan (analize per 1 ml)”, sasia 15 ML
 - Zëri i punimeve nr. 15 “Furnizim e vendosje porta metalike te reja ne vepra ekz. cope 5”, të gjithë sasinë.
- Prokurën e Posaçme të lidhur para një noteri publik Nr. 1290 Rep dhe Nr. 571 Kol. Me anë të kësaj prokure është emëruar si përfaqësues i posaçëm i bashkimit të shoqërive, shoqëria “Pesë Vëllezërit” sh.p.k.
 - Liçencë NZ.6804 e shoqërisë ”Pesë Vëllezërit”, regjistruar ne regjistrin themeltar që nga data 05.05.2016.

III.2.4 Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.2.5. Në nenin 28, pika 5, gërma “a” e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose[...].”

III.2.6. Sipas VKM–së nr.42, datë 16.01.2008 “Për mirtimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Lidhja 3, përcaktohet si më poshtë

“N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimet të kompaktësimet të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit 5 bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karierave dhe mbetjeve inerte.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh”.

III.2.7. Në deklaratën e bashkimit të përkohëshëm të shoqërive është përcaktuar se operatori ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k ndër të tjera do të realizojë këto punime: “*gërmim për skarifikim, prerje e shkulle bimë të vogla fi deri në 10 cm*” dhe “*Gërmim dheu për riseksionim kanali me ngarkim në mjet*”. Gjithashtu në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor është publikuar dokumenti “Projekt zbatimi”, në të cilin konstatohet se do të kryhen punime të tilla si: *Thell. e gërmimit, Kuota e tokës, Dist. Pjesore, Dist.progresive, etj.*

III.2.8. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se referuar Deklaratës për bashkimin e përkohshëm të shoqërive lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë “Pesë Vëllezërit” sh.p.k dhe “G.P.G Company” sh.p.k, ndarjes në përqindje të punimeve që do të kryhen dhe specifikimeve teknike, kërkohen të kryhen punime të cilat kanë lidhje me mjedisin, që përbën njëkohësisht fushën e veprimtarisë së punimeve të inxhinierisë mjedisore. Në këtë kontekst, operatori ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k në zbatim të punimeve të marra përsipër duhej detyrimisht të provonte se dispononte kategorinë e licencës N.P-12 për kryerjen e punimeve të cilat mbulojnë fushën e mjedisit, të tilla si gërmim për skarifikim, prerje e shkulle bimë të vogla fi deri në 10 cm, etj.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k konstatohet se ky operator ka marrë përsipër kryerjen e punimeve të tilla si “*gërmim dheu për riseksionim kanali me ngarkim në mjet*” dhe “*mbushje e ngjeshje me dhe për riseksionim kanali*”, në interpretimin literal i kategorisë N.S-18, nënkuptohet se do të konsiderohen si punime topogjeodezike zbatimi i relevimit topografik që kërkon mjete dhe organizim të veçantë (punime gjeodezike: rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh). Në këtë kontekst operatori ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k dhe “G.P.G Company” sh.p.k nuk është në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, pasi kryerja e punimeve të lartpërmendura kërkon domosdoshmërisht pajisjen me pikën N.S-18 licencën.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet mbi arsyet e tjera të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Pesë Vëllezërit” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër në pikën III.2.8., gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pesë Vëllezërit” sh.p.k lidhur me skualifikimin e tij për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-43800-06-30-2016 me objekt: “*Loti 1-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal in Vjosë-Levan-Fier*”-*Rehabilitim i kanalit Sekondar-Dega e Pojanit*“ me fond limit 88,221,779 lekë pa tvsh, i parashikuar për t’u zhvilluar në datën 25.07.2016, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1907 Prot; Datë 26.08.2016

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Zv/Kryetar
Spiro Kuro**

**Anëtar
Leonard Gremshi**

**Anëtar
Hektor Balluku**

**Kryetar
Gentian Këri**